



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 26.07.2019

Ref.: 1372/19D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj për periudhën 3 vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022.
 - Dizajn Grafik dhe Multimedia, BA Profesional, 180, ECTS, maksimumi 80 studentë për vit akademik;
 - Menaxhment Industrial, BSc, 180 ECTS, maksimumi 150 studentë për vit akademik;
 - Arkitektura dhe Dizajni i Interierit me Prodhime nga Druri, MSc, 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
 - Menaxhimi dhe Inovacioni ne Turizëm, MSc, 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
 - Inxhinieria dhe Informatika, MSc, 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.
- II. Obligohet Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj që deri me datë 1 Tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programeve të studimit:

AKA ka organizuar vizitën në 15 maj 2019 dhe 16 maj 2019, me qëllim të vlerësimit të institucionit dhe të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, me këtë përbërje:


Prof. Dr. Alexander Petutschnigg, Prof. Dr. Hilmi Ibar, Prof. Dr. Tauno Otto, Prof. Dr. Peeter Normak dhe z. Mihai Adrian Vilcea.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 19 qershor 2019 dhe 15 korrik 2019 ka shqyrtuar raportin final të ekspertëve ndërkombëtar për Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, dhe pas shqyrtimit të rekomandimeve përfundimtare, të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- USHAF
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

